



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, dhe nenit 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.11.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR CAKTIMIN E VEPRIMEVE TË PËRKOHËSHME PËR TRAJTIMIN E**  
**OBJEKTEVE TË MBYLLURA SHKOLLORE**

I. Me këtë Vendim përcaktohen veprimet për trajtimin e përkohshëm të objekteve shkollore të mbyllura sipas Rekomandimit të MASHT për shkak të numrit të vogël të nxënësve.

II. Objektet shkollore të cilat do të trajtohen në këtë fazë janë:

- Objekti shkollor SHFMU "Zenel Hajdini" paralelja e ndarë fizike në Vrellë të Gadimes,
- Objekti shkollor SHFMU "Fehmi Agani" paralelja e ndarë fizike në Vrellë të Goleshit
- Objekti shkollor "SHFMU " Drita " paralelja e ndarë fizike në Kojskë

III. Me qëllim të mosdëmtimit dhe shkatërrimit të tyre, objektet shkollore destinohen për përdorim për nevojat e arsyeshme të banorëve të fshatit të karakterit të përgjithshëm .

IV. Për menaxhimin e objekteve të cekura shkollore do të kujdeset Këshilli i fshatit përkatës për secilin fshat.

V. Për procedurën e transferimit të objekteve të cekura tek Këshillat e fshatrave do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

VI Objektet shkollore do të lejohen të përdoren nga banorët për një (1) ose disa ditë me Pëlqimin e Këshillit të fshatit dhe vetëm për aktivitetet që nuk bijnë në kundërshtim me rendin dhe sigurinë publike.

VII. Menaxhimi i objekteve shkollore nga Këshillat e fshatrave përkatëse do të jetë i përkohshëm deri në marjen e ndonjë Vendimi tjetër nga Komuna.

VIII. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

IX. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

15 Nr. 610/01-66265

Lipjan, më 30.11.2023

## KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

